



## Kontakti



Rruga Rexhep Luci Nr. 16/1, 10000  
Prishtinë, Kosovë.



office@cskosovo.org



www.cskosovo.org

Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike është krijuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) në kuadër të projektit "Human Rightivism" të mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe implementuar nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF).



**A JU ËSHTË SHKELUR  
E DREJTA JUAJ NGA NJË  
INSTITUCION PUBLIK?**

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

Përkruani rastin tuaj:



## Çka është Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike?

Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike është një platformë e themeluar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Kjo Qendër ka për qëllim të forcojë sundimin e ligjit në Kosovë nëpërmjet procesit gjyqësor strategjik.

## Çka është Procesi Gjyqësor Strategjik?

Procesi Gjyqësor Strategjik është dërgimi në gjykatë i rasteve nga të cilat mund të përfitojnë shumë qytetarë. Ky proces njihet si një mjet i fuqishëm për reforma ligjore, politike dhe sociale, sepse qëllimi i vet është që të arrihet një ndryshim i gjerë dhe afatgjatë, e jo vetëm që të fitohet rasti në fjalë. Po ashtu, procesi gjyqësor strategjik përfshin përdorimin e mediave, avokimit, trajnimeve dhe instrumenteve të tjera, në mënyrë që të rritet vetëdija e publikut për probleme të caktuara që duhet të rregullohen, si dhe të ushtrohet presion në autoritetet përgjegjëse që të marrin vendime të drejta dhe në kohë.

Si e para e llojit të saj në Kosovë, Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike identifikon rastet strategjike dhe pastaj i përgatit dhe i dërgon ato para gjykatave apo administratës publike. Përfaqësimi i palëve në këto raste bëhet pa pagesë nga avokatët apo juristët e Qendrës për Raste Gjyqësore Strategjike, një grup i dedikuar për të mbrojtur të drejtat e personave të përfaqësuar si dhe për të bërë ndryshimin për të gjithë ata që gjenden në pozitë të njëjtë.

## Cili është misioni i Qendrës?

Misioni i Qendrës është që të vihen në pah dhe të rregullohen problemet ekzistuese me (i) përmbajtjen e akteve juridike në Kosovë, siç janë zbrazëtitë apo paqartësitë në ligje, si dhe me (ii) implementimin apo interpretimin e këtyre akteve juridike nga institucionet publike. Duke qenë se në shumë raste institucionet publike në Kosovë shkelin të drejtat e qytetarëve duke mos zbatuar aktet juridike si duhet, misioni i Qendrës është që këto shkelje të dalin në pah e të mos përsëriten më, apo së paku, të ndëshkohen si duhet. Gjithashtu, misioni i Qendrës është që të krijohen precedentë, të ngritet vetëdija e popullit, të vihen në pah padrejtësitë, të promovohen të drejtat e njeriut si dhe të nxiten ndryshime aty ku nevojiten.

## Cilat raste i trajton Qendra?

Qendra i trajton rastet ku qytetarëve u janë shkelur të drejtat nga institucionet publike në Kosovë, pra synon të mbështesë ata që janë dëmtuar nga veprimet apo mosveprimet e administratës publike dhe gjykatave. Rastet vlerësohen nga Qendra në bazë të këtyre kriterëve:

- **Interesi Publik:** A ndikon shkelja e bërë nga institucionet publike negativisht në interesin publik? A mund të përfitojnë një numër i madh i qytetarëve nga një vendim i drejtë i gjykatës në rastin në fjalë, apo edhe vetëm nga ngritja e vetëdijes kolektive për problemin e caktuar?
- **Reformë:** A ka potencial rasti që të sjellë reforma ligjore, politike dhe sociale aty ku nevojiten?
- **Zhvillim:** A mund të sjellë rasti përfitime në zhvillimin, interpretimin apo implementimin e akteve juridike në Kosovë?
- **Standarde Ndërkombëtare:** A ka potencial rasti të sjellë standarde ndërkombëtare në legjislacionin vendor?

## Si të aplikoni në Qendër?

Nëse besoni se të drejtat tuaja janë shkelur nga një institucion publik në Kosovë, qoftë nëpërmjet veprimit apo mosveprimit, ju mund të aplikoni që ta sillni rastin tuaj në Qendër. Për të aplikuar ju duhet të shkarkoni dhe të plotësoni formën e aplikacionit që gjendet në faqen e internetit të Qendrës [www.cslkosovo.org](http://www.cslkosovo.org) sipas udhëzimeve të vendosura aty dhe ta dërgoni atë nëpërmjet emailit në [office@cslkosovo.org](mailto:office@cslkosovo.org). Gjithashtu, brenda 3 ditëve nga dërgimi i emailit, ju duhet të dërgoni formën fizike të aplikacionit në një zarf të mbyllur nëpërmjet postës së regjistruar në adresën: Rruga Rexhep Luci Nr. 16/1, 10000 Prishtinë, Kosovë. Nëse rasti juaj përzgjedhet, ju do të keni mundësinë të përfaqësoheni nga juristët e Qendrës pa pagesë.

Për më shumë informata rreth Qendrës dhe mënyrës së aplikimit ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit [www.cslkosovo.org](http://www.cslkosovo.org) apo na shkruani email në [office@cslkosovo.org](mailto:office@cslkosovo.org).

Po ashtu, ju mund të aplikoni në Qendër edhe nëpërmjet kësaj broshure, duke i plotësuar të dhënat tuaja në anën tjetër të faqes dhe duke e dërguar atë në një zarf të mbyllur në adresën: Rruga Rexhep Luci Nr. 16/1, 10000 Prishtinë, Kosovë.

